

TAKIMI I TRETË 2024 - KOMITETI SEKTORIAL I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Mbledhja e Komitetit Sektorial të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit u mbajt më datë **24.09.2024** në ambientet e shkollës “Gjergj Canco”.

Mbledhja filloi me një prezantim të historikut të shkollës: “Gjergj Canco”, stafit dhe dinamikave aktuale të shkollës. Më pas anëtarët dhe Sekretariati zhvilluan një vizitë në ambientet e shkollës, ku u njohën me klasat, labororet, ambientet e praktikave mësimore, pajisjet që shkolla dispononte për realizimin e praktikave etj.

Në përfundim të vizitës u kalua në diskutimin e një prej vendimeve të marra takimin e kaluar, konkretisht hartimin e kurseve të unifikuara afatshkurtra me kohëzgjatje 3 - 6 mujore për disa framework-e si: React, Python, Java etj. Sekretariati Teknik theksoi se, ishte e nevojshme një vendimmarrje ose një ekspertizë nga Komiteti Sektorial lidhur me kurset afatshkurtra për framework-et, me qëllim vlerësimin e mënyrës se si Qendrat e Formimit Profesional Publik (QFPP) mund t’i ofronin. U qartësua se, Komiteti duhej të merrte vendim nëse këto kurse duhej të ishin të unifikuara, apo nëse kjo kompetencë do t’u lihej QFPP, të cilat do t’i përgatisnin vetë kurset sipas nevojave lokale dhe mundësive që dispononin.

Pas diskutimeve anëtarët propozuan që të hartoheshin si kurse të unifikuar: **“Bazat e programimit në Python”**, **“Ndërtimi i aplikacionit web në Python”** dhe **“Data science”**. Anëtarët sugjeruan që, **“Bazat e programimit në Python”** mund të realizohej brenda një periudhe 3-mujore, ndërsa dy kurset e tjera për një kohë më të gjatë.

Në vijim të mbledhjes, Sekretariati prezantoi modulet e kursit të unifikuar **“Zhvillim front end-i”**, i cili ishte hartuar pas propozimit të Komitetit Sektorial. Anëtarët dakordësuan se modulet e kursit ishin ezauruese dhe ndaj u vendos që të përgatiteshin vetëm tre kurset e sipërpërmendura, ndërsa gjuhët e tjera t’u lireshin QFPP për t’i ofruar sipas kapaciteteve të tyre.

Në vijim të agjendës, diskutimi vijoi për gjysmëpërçuesit. Nga anëtarët u theksua se, nisur nga zhvillimet e fundit europiane dhe globale, pritej që në të ardhmen të kishte nevojë edhe në Shqipëri për përgatitjen e gjysmëpërçuesve. Nisur nga kjo, ata propozuan që kurrikula e elektroteknikës të pasurohej me module të reja, të cilat të përfshinin gjysmëpërçuesit dhe inteligjencën artificiale.

Çështja e fundit për diskutim lidhej me emërtimin e kualifikimit pas të mesëm, i propozuar nga KS, që kishte të bënte me mbështetjen e përdoruesve. Duke qenë se, në drejtimin e TIK ekzistonte një profil i dedikuar për **“Mbështetjen e përdoruesve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”**, anëtarët vendosën që kualifikimi pas të mesëm të emërtohej **“Mbështetje për përdorimin e sistemeve TIK”**.

Vendime të marra nga mbledhja:

- Hartimin e tre kurseve të unifikuara: ***“Bazat e programimit në Python”, “Ndërtimi i aplikacionit web në Python” dhe “Data science”***.
- Rishikimin e kurrikulave të elektroteknikës, me shtimin e moduleve për gjysmëpërçuesit.
- Hartimin e një kualifikimi pas të mesëm me emërtimin: ***“Mbështetje për përdorimin e sistemeve TIK”***.